



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullore për ndarjen e Subvencioneve 01.Nr.016-144327 të datës 30.12.2014, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 26.05.2015, merr:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim e aktiviteteve të Shoqatave dhe Klubeve sportive të Komunës së Gjiçanit

1. Me këtë vendim bëhet subvencionimi i aktivitetit të Shoqatave dhe Klubeve sportive të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Gjiçanit, për vitin 2015 dhe atë si në vijim:

Shoqatat dhe Klubet sportive	Subvencionimi-vlera
1.1. Qendra rinore-Gjiçan	5,000.00 €
1.2. Këshilli i veprimit rinor lokal-Gjiçan	5,000.00 €
1.3. Klubi i futbollit "Drita"	35,000.00 €
1.4. Klubi i futbollit "Gjiçani"	23,000.00 €
1.5. Klubi i basketbollit "Drita" (meshkujt)	10,000.00 €
1.6. Klubi i volejbollit "Drita" (femrat)	5,000.00 €

2. Shoqatat dhe klubet sportive, përfituese të subvencionimit janë të obliguara që të paraqesin projekt propozimet në të cilat duhet të përshkruajnë aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare
3. Shoqatat dhe Klubet sportive janë të obliguara që të bëjnë përmbylljen mjeteve të shpenzuar dhe për këtë të ofrojnë dëshmi në mënyrë që të përfitojnë nga ky subvencionim.
4. Mjetet financiare ndahen nga Buxhetet e Drejtorive përkatës -kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjiçan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-49460
Gjiçan, më 26.05.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi